



Pas barazimit me Flamurtarin, futbollisti nga Kosova Mentor Mazrekaj i cili luan per skuadren e Partizanit shpjegoi se skuadra ka nje rritje si dhe shpreson qe se shpejti ekipi ti tregoi vlerat e verteta me rezultate pozitive brenda dhe jashte fushes.

"Luajtem mire edhe pse nuk fituam. Po gjejme veshtiresi brenda dhe po tregojme loje me te mire ne transferte. Jemi nje ekip i mire me shume kualitete dhe mendoj se shpejti do ti tregojme vlerat tone. Penalltia mund te humbet nga çdo kush. Une nuk i gjuaj kurre penalltite", u shpreh Mazrekaj i cili shtoi se futbollit ne Shqiperi eshte me i zhvilluar se ne Kosove dhe kushtet jane me te favorshme.

"Mendoj se kampionati shqiptar eshte me i mire se ai kosovar. Eshte 2-3 hapa perpara. Luhet me fort, ka lojtare shume me cilesore dhe infrastruktura eshte me e mire se ajo ne Kosove. Une ndihem shume mire ne Shqiperi por eshte normale qe me mungon Prishtina egjithse kam luajtur boll atje", perfundoi Mazrekaj